



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 15, datë 12.12.2017

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PROJEKT GJATË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:  
“PIKË SHITJE ME PAKICË TË KARBURANTEVE DHE AMBIENTE SHËRBIMI”, ME  
VENDNDODHJE NË RRUGËN NACIONALE TIRANË-DURRËS, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28, dhe 48 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, nenit 17, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të shoqërisë “Kastrati” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit për objektin: “Pikë shitje me pakicë të karburanteve dhe ambiente shërbimi”, me vendndodhje në rrugën nacionale Tiranë-Durrës, Bashkia Tiranë, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 10, datë 23.11.2016, me subjekt zhvillues shoqërinë “Kastrati” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 10, datë 23.11.2016, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

